



REPUBLIKA E KOSOVËS – PRESIDENTI  
REPUBLIC OF KOSOVO – THE PRESIDENT  
REPUBLIKA KOSOVO – PRESEDNIK

**DEKRET PËR RATIFIKIM TË MARRËVESHJES  
NDËRKOMBËTARE**

Duke u bazuar në nenin 18, pika 2 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, në nenin 10 paragrafi 4 të Ligjit Nr. 04/L-052, për Marrëveshjet Ndërkombëtare si dhe në nenin 4, pika 3 të Ligjit Nr. 03/L-004 për Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Shërbimin Diplomatik:

**D e k r e t o j**

Ratifikimin e Marrëveshjes për Bashkëpunim në Fushat e Arsimit dhe Shkencës, ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Republikës së Kroacisë, të nënshkruar në Kosovë me 05 mars 2013 dhe të pranuar në Zyrën e Presidentit të Republikës së Kosovës me datë 04 shtator 2013.

Marrëveshja e ratifikuar i dërgohet Kuvendit të Republikës së Kosovës për njoftim, në përputhje me nenin 18, pika 3 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

Marrëveshja e ratifikuar hyn në fuqi në datën e shpalljes në Gazetën Zyrtare.

Nr. i Dekretit: DMN-018-2013.

Prishtinë, më 18 shtator 2013.

  
\_\_\_\_\_  
Atifete Jahjaga  
Presidente e Republikës së Kosovës

**MARRËVESHJE**  
**MES**  
**QEVERISË SË REPUBLIKËS SË KROACISË**  
**DHE**  
**QEVERISË SË REPUBLIKËS SË KOSOVËS**  
**PËR BASHKËPUNIMIN NË FUSHAT E ARSIMIT DHE SHKENCËS**

Qeveria e Republikës së Kroacisë dhe Qeveria e Republikës së Kosovës (këtu e tuje referuar si "Palët kontraktuese"),

dëshirojnë të zhvillojnë dhe forcojnë marrëveshjet shoqërore egzistuese mes dy vendeve;

të inkurajuar nga dëshira e përbashkët të promovojnë bashkëpunim mes vendeve të tyre në fushën e arsimit dhe shkencës;

të bindur që bashkëpunimi i tyre në fushat e arsimit dhe shkencës është një instrument me vlerë për forcimin e marrëdhënjeve mes popujve të tyre;

janë dakorduar si vijon:

**Neni 1**

Palët kontraktuese do të mbështesin dhe zhvillojnë bashkëpunim në fushat e arsimit dhe shkencës mes dy vendeve mbi parimet e barazisë dhe përfitimit reciprok.

**Neni 2**

Palët kontraktuese do të inkurajojnë shkëmbimin e eksperiencave dhe programeve në fushën e arsimit fillor dhe të mesëm.

**Neni 3**

Palët kontraktuese do të inkurajojnë bashkëpunimin direkt në mes institucioneve të arsimit të lartë të të dyja vendeve, e cila do të realizohet përmes shkëmbimit të vizitave të ekspertëve, edukatorëve dhe profesorëve mysafirë në fushat e përmendura, si dhe përmes konferencave të përbashkëta, simpoziumeve dhe seminarëve.

**Neni 4**

Sipas mundësive, secila Palë kontraktuese do të dhurojë bursa me qëllim të ofrimit të trajnimit për shtetasit e Palës tjetër kontraktuese, në institucionet e saja publike të arsimit të lartë.

**Neni 5**

Palët kontraktuese do të promovojnë mësimin e gjuhës, literaturës dhe kulturës të Palës tjetër kontraktuese.

## Neni 6

Palët kontraktuese do të inkurajojnë bashkëpunimin direkt të institucioneve shkencore dhe hulumtuese sipas mundësive dhe nevojave të tyre, që përfshijnë shkëmbimin e eksperiencave, projektet e përbashkëta, arsimimi dhe trajnimi i ekspertëve dhe hulumtuesve.

## Neni 7

Palët kontraktuese do të mbështesin bashkëpunimin e institucioneve të tyre brenda kornizës së programeve arsimore dhe shkencore të Bashkimit Evropian, Këshillit të Evropës dhe UNESCO-s.

## Neni 8

Kjo Marrëveshje nuk do të ndikojë në të drejtat dhe detyrimet të palëve kontraktuese që rrjedhin nga marrëveshje të tjera ndërkombëtare, të cilat marrëveshje i obligojnë palët.

## Neni 9

Palët kontraktuese janë dakorduar që kjo marrëveshje nuk do të përjashtojë mundësitë e formave tjera të bashkëpunimit të cilat nuk janë specifikuar në të, por janë në përputhje me objektivat e saj.

## Neni 10

Më qëllim të zbatimit të kësaj marrëveshjeje, do të themelohet një Komision i përbashkët (këtu e tutje referuar si "Komisioni"), i përbërë nga përfaqësuesit e Palëve kontraktuese. Komisioni do të takohet radhazi në Zagreb dhe Prishtinë, ndërsa datat e takimit do të dakordohen nëpërmjet kanaleve diplomatike.

Komisioni do të përgatisë programet periodike të bashkëpunimit, të cilat do të përcaktojnë detajet dhe kushtet e bashkëpunimit, në përputhje me dispozitat e kësaj marrëveshjeje dhe do të vlerësojnë dhe monitorojnë zbatimin e saj, si dhe nxjerr rekomandime të duhura me qëllim të zbatimit efektiv të saj.

## Neni 11

Kjo Marrëveshje do të hyjë në fuqi në datën e pranimit të njoftimit të fundit me shkrim me të cilën palët kontraktuese kanë njoftuar njëra tjetrën, përmes kanaleve diplomatike, të kryerjes së procedurave të brendshme ligjore të nevojshme për hyrjen e saj në fuqi.

Kjo Marrëveshje është përmbyllur për një periudhë prej pesë (5) viteve dhe automatikisht do të ripëtrihet për një periudhë pasuese prej pesë (5) viteve, vetëm nëse anulohet me shkrim nga njëra Palë kontraktuese përmes kanaleve diplomatike. Në një rast të tillë, Marrëveshja do të përfundojë gjashtë (6) muajë nga data kur Pala tjetër kontraktuese ka pranuar njoftimin e anulimit.

Në rast të përfundimit të kësaj Marrëveshjeje, dispozitat e saj do të vazhdojnë të zbatohet për çdo marrëveshje të programit të këmbimit, ose projekt i inicuar sipas kësaj Marrëveshjeje dhe që është ende në zhvillim e sipër, deri në përfundimin e tyre, përveç kur Palët bien dakord ndryshe.

Kjo Marrëveshje mund të ndryshohet me pëlqimin e ndërsjellë dhe me kërkesë të njëres prej Palëve kontraktuese. Ndryshimet e miratuara do të hyjë në fuqi sipas procedurave të parapara në paragrafin e parë të këtij Neni.

Për vërtetim, të nënshkruarit e autorizuar, sipas rregullave të Qeverive të tyre, kanë nënshkruar këtë Marrëveshje.

E nënshkruar në KOSOVË MASHT më 05.03.2013, në dy kopje origjinale, secila në gjuhën Kroate, Shqipe dhe Angleze, i tërë teksti është i njëjtë. Në rast të ndonjë divergjence në interpretim, teksti në gjuhën angleze do të jetë autoritativ.

Për Qeverinë  
e Republikës së Kroacisë



Për Qeverinë  
e Republikës së Kosovës

